

## **ALQI BLLAKO**

**Datëlindja:** 10.05.1987

**Vendlindja:** Ersekë

**Email:** Alqi.Bllako@parlament.al



### **Jetëshkrimi:**

Ka përfunduar studimet e larta pranë Universitetit të New York, Tiranë si dhe ka kryer disa studime pasuniversitare, Master në profilin Bankë dhe Tregje Financiare (2009-2011) pranë UNYT – Kurt Bösch University Institute, në vitet 2010-2012 Master në profilin Financë dhe Kontabilitet pranë UNYT dhe nga viti 2018 e në vijim Master në profilin Administrim Publik pranë Hertie School of Governance, Berlin.

Prej diplomimit të tij e në vijim, z. Bllako ka pasur disa eksperiencë pune. Në vitet 2009-2010 ai ka punuar si koordinator projektesh në rrjetin e Studentëve Shqiptarë në Botë. Në periudhën 2010-2011 ai ka qenë i punësuar si analist pranë një kompanie telekomunikacioni. Prej vitit 2011-2013, ai ka qenë i angazhuar si lektor pranë Universitetin e New York-ut Tiranë.

Ai ka disa eksperiencë pune si drejtues në disa institucione shtetërore. Prej vitit 2013-2017 ka ushtruar detyrën e sekretarit të përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit dhe në periudhën 2017-2018 ka qenë sekretar i përgjithshëm në Institucionin e Presidentit. Prej vitit 2018-2019 ka qenë drejtor ekzekutiv pranë Albanian Gas Service Company. Së fundmi, prej vitit 2019-2021 ka mbajtur funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve.

Z. Bllako është vlerësuar me Çmimin e Parë nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për diplomën më të mirë. Në vitin 2017, është diplomuar në kursin e studimeve të sigurisë dhe mbrojtës në Akademinë e Forcave të Armatosura. Në 2018, ai është certifikuar mbi sigurinë evropiane nga Qendra Evropiane për Studimet e Sigurisë, Qendra Marshall.

Prej vitit 2015-2017 ai ka mbajtur disa pozicione si koordinator kombëtar, Konventa e Diversitetit Biologjik dhe në Trupin Ndihmës për Këshillat Shkencore, Teknike dhe

Teknologjike – Konventa e Diversitetit Biologjik. Nga viti 2016-2017 ka qënë autoritet kombëtar i deleguar pranë Fondit të Gjëlber të Klimës.